

Website of the Ministry of Local Government and Administration, 21.03.2012, available at:
<http://mapl.rks-gov.net/News/2011/Zevendesministri-i-MAPL-se,-Basri-Musmurati-merr-p.aspx>

Zëvendësministri i MAPL-së, Basri Musmurati merr pjesë në takim in e pestë drejtues të LOGOS-it

21 mars 2012



Në fshatin Ropotovë e madhe/Komuna e Ranillugut, u organizua Komiteti i pestë drejtues Zvicër-Kosovë, përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim/LOGOS.

Në këtë takim ishin të ftuar Zëvendësministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Basri Musmurati, Përfaqësues nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovë/AKK, si dhe kryetarët e komunave partnere: Han i Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Klllokot, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpçë dhe Viti.

Më këtë rast, Zëvendësministri Musmurati ka përhëndetur të pranishmit duke falënderuar Komunitat për një bashkëpunim të mirë dhe të mëtutjeshëm me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

“MAPL vazhdon të bashkëpunojë me komunitat e Kosovës dhe brenda buxhetit përpiqet të vlerësojë projekte të ndryshme të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në përmirësimin jetës së qytetarëve, por edhe në ngritjen e kapaciteteve komunale” - theksoi zëvendësministri Musmurati.

Në vazhdim, Norbet Pijls, koordinator i projektit LOGOS, prezantoi Raportin vjetor 2011 dhe

Planin Vjetor të Veprimit 2012 për komunat e përzgjedhura partnere në Kosovën Jug-lindore: Han i Elezit, Kaçanik, Kllokot, Kamenicë, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpcë dhe Viti.

Gjatë këtij takimi Kryetari i Komunës së Kamenicës, z. Shaip Surdulli dhe nënkryetari i Komunës Han i Elezit, i kërkuan Zëvendësministrit Musmurati, të ndikojë në Kuvend dhe të llojë për aprovimin sa më të shpejtë të Ligjit për ndërmarrjet publike .

Në fund të takimit, Koordinator i LOGOS-it, Norbert Pijls, nënshkroi kontratat me komunat që kanë përfunduar dorëzimin e dokumentacionit të projektit për investim në vlerë prej 40 mijë euro për secilën komunë.

Takimi i radhës është caktuar të mbahet rreth muajit shtator.